



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0242

Paneli Shqyrtues, i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga panelisti individual Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (GOE) Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. „kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, Komuna e Parteshit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Ri-Tender: "Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet me numër të prokurimit: 658-24-7751-5-2-1" , me 05/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. me nr. 2025/0242, e datës 03/04/2025 kundër vendimit AK/ Komuna e Parteshit lidhur me aktivitetin e prokurimit;” Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet”, me numër të prokurimit 658-24-7751-5-2-1.

2. Anulohet, Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates 19.03.2025 AK-Komuna Partesh, lidhur me aktivitetin e prokurimit ” Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet” me të dhënat si në pikën 1(një) të vendimit dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

3. Konstatohet ankesa si çështje e gjykuar "Res Judicata" sipas nenit, 105 paragrafi 2.16 i LPP-së, dhe nenit 23.11 e Rregullores Punës OSHP, rastet e perseritura. OSHP çështjen e ka trajtuar me; Vendimin PSh. nr. 2024/1144 dhe obligohet AK, për zbatim të vendimit.

4. Obligohet autoriteti kontraktues, të ndermarr veprimet per zbatimin e ketij vendimi, lidhur me aktivitetin e prokurimit dhe në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndermarrë masa ndaj AK për mos zbatim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

5. Bazuar në faktin e aprovimit si të bazuar të ankesës të GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K., u vendos të njëjti ti kthehet tarifa e ankesës e paguar për parashtrim të ankesës, sipas nenit 31.4 Rregullores Punës OSHP-së. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të Rregullores Punës OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 26.07.2024, Komuna e Parteshit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet me numër të prokurimit 658-24-7751-5-2-1.

Ndërsa me datën 19.03.2025 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate GOE Jana SH.P.K. & EL Bau SH.P.K. ne vlere totale te ofertës 207,005.78 Euro.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës punë dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 211,275.30 €.

Me 24.03.2025, GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 01.04.2025 Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 03.04.2025, OSHP ka pranuar ankesën nga GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K., me nr. 0242/2025 për lidhur me aktivitetin Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet me numër të prokurimit 658-24-7751-5-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

OSHP ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e GOE ankuesDua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi :Eliminimi i padrejtë për shkak të gjuhës së dokumentit

- AK ka eliminuar ofertën për shkak se një faturë e makinerisë (eskavatorit) ishte në gjuhën gjermane.
- Sipas nenit 13, pika 4 të LPP-së, dokumentet lejohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze. Megjithatë, për dokumente sipas neneve 65-71 të LPP-së, sipas nenit 72 lejohen sqarime dhe

përkthime zyrtare pas dorëzimit.

- KRPP në interpretimin përkatës (pyetja nr. 7) ka qartësuar që për dokumente të tilla mund të kërkohej përkthim, prandaj AK është dashur të kërkonte sqarim, jo të eliminonte ofertën.

Pretendimi i dytë (II): Eliminimi për mungesë të librezave të qarkullimit për makineri që nuk janë të regjistrueshme

- AK ka eliminuar ofertën për shkak se nuk janë dorëzuar librezat të qarkullimit për Damper mbi 3 ton dhe Eskavator me lugë ngarkuese.
- Pretendimi është se këto mjete nuk janë të obliguara të regjistrohen sipas Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjetet dhe Udhëzimit Administrativ MPB NR.01/2018.
- Mjetet nuk përdoren në rrugë publike, por për punë në terren të mbyllur (rregullim të shtratit të lumit), ndaj nuk ka kërkesë ligjore për regjistrim.

Pretendimi i tretë (III): Shkelje e parimit “Res Judicata” – Vendimi i OSHP-së nuk është respektuar

- OSHP me vendimin PSH.nr.2024/1144 ka konstatuar se eliminimi ka qenë i padrejtë dhe ka urdhëruar rivlerësim.
- AK ka përsëritur të njëjtin arsyetim për eliminim, pa përfillur vendimin e mëparshëm të OSHP-së, duke cenuar parimin e res judicata të nenit 105 të LPP-së.

Pretendimi i katërt (IV): Eliminimi pavarësisht ekzistencës së dokumentacionit të plotë në gjuhë zyrtare

- Është dorëzuar urdhërpagesë në gjuhën shqipe për të njëjtën makineri për të cilën ishte ofruar fatura në gjuhën gjermane.
- Dokumentacioni është konsideruar i plotë dhe në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit.

Pretendimi i pestë (V): Mosrespektimi i të drejtës për qasje në dokumentacion

- Pas rivlerësimit, OE ka kërkuar qasje në ofertën e grupit të OE të rekomanduar për kontratë.
- Qasja nuk është lejuar plotësisht me arsyetimin se dokumentet janë “sekret afarist”.
- Paneli shqyrtues i OSHP-së ka konstatuar që dokumentet e tilla (si deklarata nga banka) nuk përbëjnë sekret afarist.
- AK nuk ka përgatitur version të pastruar të dokumenteve, siç kërkohej nga neni 11 i LPP-së.

Pretendimi i gjashtë (VI): Sqarimi i jashtëligjshëm i dokumentit bankar nga grupi i OE të rekomanduar

- Grupi i OE të rekomanduar ka ofruar dokument bankar (letër përkrahje) që nuk përmbushte kërkesat për dëshmi të mjeteve ose qasje për kredi.
- Më pas janë ofruar sqarime dhe dokumente shtesë, të cilat janë të ndaluara me ligj pasi nuk janë dorëzuar brenda afatit të dorëzimit të ofertave.
- Prandaj, ky grup OE konsiderohet i papërgjegjshëm.

Pretendimi i shtatë (VII): Dyshim për mosvazhdim të validitetit të ofertës dhe sigurimit të tenderit nga grupi i OE të rekomanduar

- Kërkohej verifikim nëse grupi i OE të rekomanduar ka vazhduar ofertën dhe sigurimin e tenderit, pasi OE nuk ka pasur qasje në dokumentacion për ta verifikuar.

Pretendimi i tetë (VIII): Grupi tjetër i OE është i papërgjegjshëm për mungesë të dokumenteve të noterizuara

- Grupi i OE: KUSHTRIMI NM SH.P.K.; AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Xhemshir Sejdiya B.I.
- Dokumentet për inxhinierë (diploma dhe kontrata pune) janë dorëzuar pa noterizim.

Pretendimi i nëntë (IX): Mungesë e certifikatës sipas kërkesës së dosjes së tenderit

- Është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit në punishte.
- Është ofruar certifikatë ISO 14001:2015 për sistem të menaxhimit të mjedisit, por nuk dëshmon për menaxhim specifik të mjedisit në punishte, siç kërkohej në dosje.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim:

Më datë 24.03.2025, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Parteshit, përmes platformës e-prokurimi, ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga grupi i operatorëve ekonomikë: “Dua Arch” SH.P.K & “Pro&Co Group” SH.P.K & “NNT ABC” & “NNT Bini” SH.P.K, lidhur me kundërshtimin e arsytimit të AK-së për eliminimin e ofertës së tyre, si dhe atakimin e vendimit të AK-së për dhënien e kontratës, me arsytimin se kinse procesi i vlerësimit nuk është zhvilluar në harmoni me dispozitat ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

Mbi këto arsye, grupi i operatorëve ekonomikë ankues konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 1, 7, 10, 11, 59, 60, 69, 72 të LPP-së dhe nenin 40.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, me kërkesë që AK – Komuna e Parteshit të aprovojë kërkesën si të bazuar dhe të anulojë vendimin për dhënien e kontratës të datës 19.03.2025, në mënyrë që lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Parteshit ka konstatuar se Kërkesa për Rishqyrtim e OE ankues është ushtruar brenda afatit ligjor në pajtim me nenin 108/A paragrafi 3.1 të LPP-së, sipas procedurës paraprake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, dhe si e tillë i përmban shumicën nga elementet e përcaktuara me nenin 60, paragrafi 3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në këtë mënyrë, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit të AK – Komuna e Parteshit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP-së, lidhur me nenet 61, 62 dhe 63 të RRPP-së, dhe se nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e GOE sipas kësaj kërkesë janë parashtruar (prezentohen shkurtimisht) si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, pavarësisht se i ka analizuar të gjitha pretendimet ankimore në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të kësaj lënde, nuk e konsideroi të nevojshme që të përshkruajë dhe shtjellojë në detaje secilin pretendim ankimor, por për nevojat e këtij vendimi janë përshkruar shkurtimisht, përderisa të njëjtat në detaje janë evidentuar në kërkesën për rishqyrtim.

Pretendimi i parë (I):

GOE është eliminuar nga tenderi për shkak se në dosjen e tenderit, në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe profesionale, tek kërkesa mbi makineritë (pika 12), është kërkuar: “Eskavator me lugë ngarkuese para dhe prapa – 2 copë”. GOE ka dorëzuar një faturë me nr. 29-04-2016 në gjuhën gjermane, e cila është në kundërshtim me nenin 13, pika 4 të LPP-së, e cila përcakton se një ofertë, kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe, serbe ose në gjuhën angleze. Në mungesë të një dokumenti në këto gjuhë, oferta vlerësohet si e papërgjegjshme nga Komisioni i rivlerësimit.

Gjithashtu, nuk është dorëzuar librezë e qarkullimit për mjetin “Damper mbi 3 ton – 1 copë”. Në vend të librezës së qarkullimit me regjistrim valid, është ofruar një faturë e datës 15.10.2019 me nr. 606-19-DVDIX me nr. R 8573 të datës 15.04.2019 për makinerinë "Trakker Neuson", modeli 5001, viti i prodhimit 2000, e cila nuk dëshmon rregullsinë teknike dhe regjistrimin e "Damper mbi 3 ton – 1 copë", ashtu siç kërkohet në Ligjin Nr. 05/L-132 për Automjetet dhe Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve.

Përgjigja e AK-së lidhur me pretendimin e parë:

AK konstaton se, sipas letrës standarde të eliminimit, për mjetet që i nënshtrohen regjistrimit, nuk keni ofruar dokumentacionin përkatës të regjistrimit valid, siç kërkohet me Ligjin 05/L-132 për Automjetet dhe Udhëzimin Administrativ MPB nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve. Sa i përket konstatimit tuaj se këto mjete nuk regjistrohen, kjo nuk qëndron, sepse sipas nenit 39, pika 3 të ligjit të sipërcekur, “në trafikun rrugor nuk mund të marrin pjesë mjetet e paregjistruara si motokultivatorët dhe mjetet e punës. Nëse këto mjete marrin pjesë në trafikun rrugor, duhet të jenë të regjistruara dhe t’i kenë sistemet dhe pajisjet e përcaktuara teknikisht në rregull”.

OE i shpallur fitues i ka ofruar këto pajisje me regjistrim valid, duke dëshmuar rregullsinë e tyre teknike. Andaj, pretendimi juaj është i pabazuar.

Pretendimi i dytë (II):

Sa i përket arsyes së eliminimit për shkak të dorëzimit të një fature në gjuhën gjermane, sqarojmë se ky dokument bën pjesë në dokumentet sipas neneve 65–71 të LPP-së, ku në raste të tilla lejohet që të kërkohet përkthim zyrtar. Këtë e ka qartësuar edhe interpretimi i KRPP-së tek pyetja nr. 7, ku thuhet se për dokumente të tilla mund të kërkohet përkthim zyrtar, por nuk ka ndalim të dorëzimit të tyre.

AK ka pasur mundësi të kërkojë sqarime, por kjo nuk është bërë. Për më tepër, fatura nuk përbën ndonjë relevancë të theksuar sepse me dosjen e tenderit është bashkangjitur edhe një kontratë për eskavator me lugë ngarkuese para dhe prapa (2 copë), prandaj kërkesa konsiderohet e plotësuar.

Përgjigja e AK-së lidhur me pretendimin e dytë:

Ju nuk i plotësoni kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. GOE ka dorëzuar një faturë në gjuhën gjermane, e cila është në kundërshtim me nenin 13, pika 4 të LPP-së. Për pajisjet që kërkojnë regjistrim, është kërkuar dëshmi mbi pronësinë – librezë e qarkullimit me regjistrim valid; për ato që nuk regjistrohen – kontratë blerjeje, faturë apo dokument doganor. Nëse ka marrëveshje huazimi, ajo duhet të jetë e nënshkruar, vulosur dhe e noterizuar.

Ju nuk keni bashkangjitur një dokument në gjuhën shqipe, serbe apo angleze dhe të noterizuar. Prandaj, pretendimi është i pabazuar.

Lidhur me qasjen në dokumente:

Në njoftimin mbi vendimin, përkatësisht në formularin B58, kemi kërkuar qasje në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo përsëri nuk na është lejuar qasje e plotë. Na është dorëzuar vetëm një kërkesë për sqarime, e datës 25.02.2025, dërguar grupit të OE të rekomanduar për kontratë, ku janë kërkuar sqarime lidhur me kapacitetin teknik dhe financiar.

Në këtë kërkesë thuhet se OE duhet të ketë:

1. Qarkullim në shumën prej së paku 350,000.00 euro;
2. Së paku 50,000.00 euro asete në llogari bankare ose vërtetim për kredi nga ndonjë bankë.

Janë kërkuar dëshmi si: deklaratë nga ATK ose raport financiar dhe deklaratë nga banka që vërteton disponueshmërinë e mjeteve apo mundësinë për kredi. Komisioni profesional ka kërkuar

sqarime nëse kanë pasur mjete të gatshme në llogari bankare sipas kërkesës së tenderit.

Sqarimet janë kërkuar, mirëpo përgjigjet dhe dëshmitë e ofruara nga grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk na janë bërë të ditura. Moslejimi i qasjes në dokumentet e ofertuesit fitues e bën të pamundur vlerësimin objektiv të ligjshmërisë së vendimit për dhënien e kontratës dhe përbën shkelje të parimit të transparencës, të garantuar me nenin 7 të LPP-së.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 08/04/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0242/2025, ndërsa me datë 26/04/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2025/0242, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është Pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa OE është pajtuar lidhur me rekomandimin e ekspertit.

- Eksperti Shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0242 ,lidhur me pretendimet e GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. ka vlerësuar si në vijim:

Duke u mbështetur në ekzaminimin e lëndës, konstatojmë si në vijimë:

Përgjigje në Pretendimin nr. 1.

OE “Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK ,pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk e ka respektuar qellimin e nenin 1 të LPP-së

Ekspertja thekson se ndër tjera qellim i këtij neni është ti udhëzoj autoritetet kontraktuese që të sigurojnë menyrë ma efikase ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen , procedurat që do te ndiqen ,te drejtat qe do te respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen,nga personat ,operatoret ekonomik ,dhe nga autoritetet kontraktuese si dhe të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve public dhe personave te tjerë që janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit .

AK e ka trajtuar OE ankues si të eliminuar,duke e njoftuar se nuk janë plotësuar kreteret e kapacitetit teknik dhe professional ,perkatsisht nuk janë përmbushur keto dy kriteret me arsyetimin se nuk janë dorëzuar librezat e qarkullimit per Damper dhe Eskavator shih se si ka qen kriteri me DT dhe NJK :

Kerkesa :

9).Damper mbi 3 ton - 1 cope dhe

12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope.

Deshimia:

Deshmia 1. per te gjitha paisjet qe rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , libreza e qarkullimit me rexhistrim valid, per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin

(kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar .

Ekspertja sqaron vlerësimi nuk është bërë në harmoni me nenin 1 të LPP-së sepse nuk janë zbatuar kushtet,rregullat e parapara me dosjen e tenderit sikurse ishte paraparë per keto dy kriteret ku me DT dhe me njoftimin per kontratë per pajisjet qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar , e në rastin konkret kerkesa e paraparë me piken 9 dhe 12 si Damperi dhe Eskavatet dihet se janë mjete te punës dhe te njejtat me paragrafin 1.2 te nenit 9 te Ligjit nr .05/L-132 perjashtohen nga homologimi,ligji i perjashton disa pajisje ushtarake dhe mjetet e punë edhe pse decidivisht nuk e specifikon pajisjet në fjalë mirëpo konsideroj se keto dy lloje te pajisjeve hyjn te mjetet e punës për qka edhe janë te destinuara dhe te kerkuara per këtë aktivitet të prokurimit ,andaj konsideroj se qendron pretendimi i OE ankues sepse regjistrimi per keto pajisje nuk është i obligueshëm dhe per te njejtat duhet te vlejn deshmit qe janë kerkuar per paisje qe nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontrat e blerjes,fature ose Dud doganor. Nese ka marveshje huazimi marveshja duhet te jete e nenshkruar dhe vulosur nga dy palet dhe e noterizuar,andaj qendron pretendimi i OE ankues ,e sa i perket fatures ne gjuhen gjermane do ta gjeni pergjigijen te pretendimi perkates më posht.

Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njejt pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njejt në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judikata”

Andaj , Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 2.

OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk e ka respektuar neninn 7 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i këtij neni është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit .

Ekspertja sqaron se qendron pretendimi sepse Autoriteti Kontraktues e ka eliminuar OE ankues për dokumente që nuk ka qen e domosdoshme te dorezohen sikur u sqasua më lart për librezat e qarkullimit me regjistrim valid .

Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njejt pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe njejt në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judikata”

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 3 dhe 4.

OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk e ka respektuar neninn 10 dhe 11 të LPP-së .

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 10 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në menyrë transparente ,pra AK në secilen fazë duhet ti përdor mjetet për promovimin e transparences qe nenkupton edhe në fazen e qasjes ne dokumente publike ,si dhe ndër të tjera qellim i nenit 11 të LPP-së është të udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet ti trajtojë informatat sekrete afariste .

OE ankues nder te tjera pretendon se per oferten e grupit te OE fitues AK nuk ka dhenë qasje ne tërë oferten-dokumentacionin i njejt i e specifikon se ne dokumentin per mbeshtetje bankare është kerkuar sqarim nga OE fitues dhe deshmit e ofruara nga banka nuk na janë dhenë në qasje ne kete dokument.

Ekspertja sqaron se disa dokumente janë te mbrojtura me legj mirëpo është kusht qe per te njejtat te plotsohet kerkesa për konfidencialitet e cila gjindet ne dosjen e tenderit ,gjithashtu ekspertja sqaron se OE i shpallur fitues e ka plotsuar këtë kusht sepse e ka plotesuar kerkesen per konfidencialitet,mirëpo e njejt konsideron se dokumenti qe deshmon se ka perkrahje nga banka nuk hynë te dokumentet konfidenciale sepse i njejt ishte kriter i pararë me NJK dhe DT dhe i njejt leshohet nga banka me qellim qe te deshmohej se OE ka perkrahje apo mundë te marr kredi ne vlerën e paraparë nga autoriteti kontraktues,mirëpo me rastin e sqarimeve grupi i OE i shpallur fitues nuk ka sjellur dokument per perkrahje nga banka i cili dokument nuk do te ishte sekret afarist siq kemi theksuar edhe me ekspertizen paraparake,por grupi i OE ka sjellur dëshmi bankare qe posedon mjete financiare ma shumë se sa që janë kerkuar ky dokument konsideroj se e ploteson kriterin e paraparë sepse dëshmia që posedon mjete financiare është ekuivalente apo edhe ma e favorshme se sa dokumenti qe leshon banka per perkrahje,pra me rastin e Rivlerësimit AK ka kerkua sqarime në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP-së dhe sqarimet janë bërë permes platformes se e-prokurimit dhe me keto sqarime grupi i OE i shpallur fitues ka deshmuar se e plotëson këtë kriter,pra ka ofruar dëshmi te nxierr me date 05.08.2024 se posedon 81,436.28€,pra edhe dita e hapjes se ofertave ishte 05.08.2024 andaj nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse ky dokument ka numrin e gjirolllogaris dhe konsideroj se hynë në dokumentet konfidenciale andaj sqaroj se dokumenti e plotëson kriterin e paraparë dhe i njejt hyn te dokumentet konfidenciale.

Ndersa qasje per valeditetin e dhe sigurimin e tenderit nuk është konfidenciale dhe per te njejtat qendron pretendimi i OE ankues

Andaj

Ekspertja sqaron se ky pretendim është pjeserisht i bazuarë.

Përgjigje në Pretendimin nr. 5 nr.6,nr 7,nr.8 dhe pretendimi nr. 9. dhe 10

OE “Dua arch SH.P.K & Pro&Co Group&NNT ABC&NNT Bini SHPK pretendon se A.K., Komuna Partesh nuk ka respektuar nenin 59,60,69 dhe 72 të LPP-së,si dhe neni 40 të RRPP-së dhe neni 10 i udhezuesit per prokurimim publik nr 001/2023 si dhe vendimin e OSHP-së nr 2024/1144 i dt 23.01.2025

Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 59 te LPP-së dhe nenit 40 të RRPP-së është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese se si duhet të bëhet Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahassimi i tenderëve ,fillimisht autoriteti kontraktues ka themeluar komision të vlerësimit,i cili pasi i ka vleresuarë ofertat e pranuar ka dhënë rekomandim dhe i njejt rekomandim është aprovuar nga

udheheqesi i prokurimit,gjithashtu Ekspertja thekson se ndër të tjera qellim i nenit 60 dhe 69 te LPP-së është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese në respektimin e kriterëve për dhenjen e kontrates dhe respektimin e kriterëve për nga aftësia teknike dhe profesionale ,gjithashtu ekspertja sqaron se qellimi i nenit 72 te LPP-së është ti udhëzojë autoritetet kontraktuese për mundësin e sqarimit të dokumenteve gjatë fazës së vlerësimit për dokumentet ekzistenca e tecilave është fikesuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tendereve ,që nderlidhet edhe me neni 10 i udhëzuesit për prokurimim publik nr 001/2023 si dhe vendimin e OSHP-së nr 2024/1144 i dt 23.01.2025 .

OE ankues ndër të tjera pretendon se oferta e tijë padrejtesisht është trajtuar se nuk i plotëson këto kriterë si :

Kerkesa :

9).Dampër mbi 3 ton - 1 cope dhe

12).Eskavator me luge ngarkuese para dhe mbrapa - 2 cope.

Deshimia:

Deshmia 1. për të gjitha paisjet që rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronsin e tyre , librezë e qarkullimit me rexhistrim valid, për paisje që nuk rexhistrohen kerkohet deshmi mbi pronesin (kontratë e blerjes,fature ose Dud doganor. Nëse ka marveshje huazimi marveshja duhet të jetë e nënshkruar dhe vëlosur nga dy paletë dhe e noterizuar .

Ekspertja sqaron se siq u sqarua në pretendimin nr 1 kjo pikë pretenduese është e bazuarë sepse OE ankues është eliminuar për këto dy pajisje se nuk kanë librezë për qarkullim me regjistrim valid ,ekspertja sqaron se ky eliminim nuk është i bazuar në kriteret e parapara me NJK dhe DT sepse për pajisjet që nuk regjistrohen nuk është kërkuar Librezë për më gjerësisht shih kriterin më lart dhe sqarimin në pretendimin nr 1 të kësaj ekspertize .

OE ankues pretendon se : sa i përket fatures e cila është në gjuhën gjermane e nuk është në gjuhën e lejuara siq është Gjuha Shqipe ,Gjuha angleze dhe Gjuha serbe,OE ankues pretendon se përveq kësaj fature është bashkangjitur edhe urdherpagese në gjuhën shqipe për eskavator (skip) me luge ngarkuese para dhe prapa e datës 10.05.2024 dhe i njëjti pretendon se kjo deshmi është relevante me faturen dhe plotëson kriterin e paraparë me dosjen e tenderit ,i njëjti thekson se me interpretimin nr 7 është sqaruar se për dokumentet që bëjnë pjesë në nenin 65 -71 të LPP-së në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kerkohet nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument .

Ekspertja më vëmendje e ka analizuar këtë pretendim dhe sqarimin e KRPP-së dhe vjen në përfundim se qëndron pretendimi i OE ankues sepse parimisht për faturen e dorëzuar në gjuhën gjermane në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkojë nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të të njëjtit dokument.

Se ky pretendim qëndron e ka vërtetuar Opinioni I KRPP-së nr. 7 . ku më të njëjtin opinion lejohet të kerkohet përkthime për dokumentet që bëjnë pjesë në nenin 65-71 të LPP-së ku edhe fatura bënë pjesë në këto dokumente për të cilat KRPP ka sqaruar se lejohet të dorëzohen përkthime për këto dokumente,shih Opinioni e KRPP-së :

7. 22.11.2022 A duhet të refuzohet tenderi apo të kërkohet sqarime sipas 72, i cili ka sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me LPP? Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjen e parashtruar, KRPP ofron OPINIONIN si në vijim: Neni 13.4 i LPP-së në lidhje me gjuhët zyrtare të procedurës së tenderimit përcakton: “13.4 Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze” Kjo dispozitë në mënyrë të qartë përsëritet në format standarde të dokumenteve të tenderimit të miratuara nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me LPP. Sipas dispozitave të lartpërmendura tenderët mund të dorëzohen vetëm në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ligji siç shihet nuk lejon ndonjë përjashtim në rastin e lartpërmendur. Në LPP dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me ligj, nuk përcaktohet zgjidhja për AK-në se si duhet të veprojë në rast se një tenderues paraqet ndonjë nga dokumentet e tenderit në një gjuhë tjetër nga ajo e autorizuar me nenin 13 të LPP-së.

Si rrjedhojë, bazuar në nenin 13 të LPP-së dhe format standarde (dokumentet e tenderimit), KRPP ofron këtë OPINION: Në rast se një operator ekonomik dorëzon specifikimet teknike në një gjuhë tjetër (psh. në Gjuhën Gjermane, Italiane apo cilëndo gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me këtë ligj), me pasojë që Komisioni i Vlerësimit nuk është në pozitë që të vlerësojë tenderin. Në këtë rast, duhet të merren parasysh si në vijim: 1) neni 13.4 nuk lejon asnjë përjashtim nga gjuhët e përmendura. As format standarde të cilat imponojnë AK për të miratuar të gjitha ose disa nga gjuhët e përcaktuara në nenin 13.4. Përveç kësaj, duhet të ceket se LPP-ja, përveç gjuhës shqipe dhe serbe, tashmë e lejon përdorimin edhe të Gjuhës Angleze. Zgjedhja e ligjvënësit është bërë në faktin se, duke qenë Gjuha Shqipe dhe Serbe jo shumë e përhapur, Gjuha Angleze lejon pjesëmarrjen e Operatoreve të huaj Ekonomik, pasi që është gjuha që përdoret ndërkombëtarisht; 2) në rastin e përmendur, është menduar, se specifikimet teknike të produktit të ofruar nga OE në fjalë do të duhet të ishin në dispozicion, jo vetëm në gjuhën e tenderuesit, por edhe në gjuhën angleze. Sipas përvojës, në fakt, specifikimet teknike të çdo produkti që ka relevancë ndërkombëtare zakonisht janë në dispozicion në gjuhën angleze. Kur ato nuk janë në dispozicion, OE në fjalë duhet të ketë dorëzuar, në vend të specifikimeve teknike në gjuhën e tenderuesit, një përkthim të certifikuar në anglisht për specifikimet teknike. Pra, sjellja e OE që sjellë dokumente në gjuhë tjetër nga ato të lejuara me ligj, është neglizhencë dhe plotësisht e pavarur nga një dispozitë e veçantë në dokumentet e tenderit. 3) Dispozita e lartpërmendur e LPP-së e cila përcakton përdorimin e gjuhëve gjatë procedurave të tenderimit është e përshkruar në mënyrë që të vë komisionin vlerësues në pozitë më të mirë për të vlerësuar përmbajtjen e tenderit. Në parim, prodhimi i dokumenteve i cili nuk është i shoqëruar me një përkthim zyrtar është ekuivalente me mos-prodhim të të njëjtit, pasi që pengon autoritetin kontraktues që të ketë njohuri të menjëhershme dhe të drejtpërdrejtë për elementet përkatëse të tenderit.

4) parimi i lartpërmendur mund të ketë një shmangie kur nuk ka të bëjë me pjesë thelbësore të tenderit, si për shembull broshura, anekse ose dokumente të tjera që kanë karakter jo të detyrueshëm, por thjesht dorëzohen nga OE për të përshkruar më mirë produktin e ofruar. Në të kundërt, në rastin e përmendur, OE ka paraqitur në një gjuhë tjetër specifikimet teknike të cilat

përfaqësojnë një pjesë thelbësore dhe të nevojshme për pranimin e tenderuesit. Kështu, duke pasur parasysh konsideratat e lartpërmendura, tenderi i cili ofron specifikimet teknike në gjuhë tjetër nga ajo e përcaktuar me LPP, duhet të përjashtohet. Ndërsa për cilindo dokument tjetër të kërkuar si dëshmi sipas nenit 65-71 të LPP-së, në përputhje me nenin 72 të LPP-së mund të kërkohej nga OE që të dorëzojë një përkthim zyrtar të njëjtit dokument.

Andaj . Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

OE ankues nderë tjera pretendon se OE i shpallur fitues është i pa përgjegjshëm me arsyet e si me poshtë :Grupi i OE të rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50 mijë euro ose vërtetim bankar që kompania mund të marrë kredi në shumën e lartcekur, dhe thekson se për këtë kriter nuk mundë të kërkohej sqarime ,gjithashtu thekson se për këtë pretendim është konstatuar nga Ekspertja shqyrtuese dhe i njëjti konstatim është mbështetur nga paneli shqyrtues me nr 2024/1144 .

Ekspertja paraprakisht në ekspertizën paraprake e ka analizuar Letren e leshuar me datë 02.08.2024 nga NLB banka për OE e shpallur fitues dhe bazuar në konkluzionin e fundit kjo leter nuk e kishte plotësuar kriterin e paraparë me NJK dhe DT sepse ndër tjera në këtë leter shkruan se :*Nëse subjekti juridik JANA SH.P.K kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin/ tenderin e lartcekur, për shumën deri, por duke mos tejkaluar EUR (me fjalë: EUR Pesëdhjetë mijë), banka do shqyrtojë financimin e tij, bazuar në procedurat e saj të brendshme.*

Ekspertja me ekspertizën ka sqaruar se banka ka theksuar se nëse subjekti kërkon mbështetje financiare lidhur me projektin ,banka do të shqyrtojë financimin e tij ,sqarim më i detajuar gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës për mbështetje financiare mund të leshohet kredia por edhe mundë të refuzohet ,e që do të thotë se nuk ka deklaratë nga banka që vërteton disponueshmërinë në llogari bankare ose vërtetim bankar që kompania mund të marrë kredi deri në shumën e lartcekur .

Andaj kishte ardhur në përfundim se ky pretendim është i bazuarë.

Mirëpo me rastin e rivlerësimit për këtë kriter AK ka kërkuar sqarime shtesë dhe grupi i OE ka dëshmuar se posedon mjete financiare ,ku ka bashkangjitur deklaratë nga banka se posedon mjete financiare në bankë ,më gjerësisht për datën dhe shumën që posedon e gjeni në pretendimin paraprak 3 dhe 4 të këtij raporti,si dhe ndryshimet në Ri-vlerësim që kanë të bëjnë me vlerësimin e par ,pra herën e par AK e kishte marrë si të mirëqenë dëshminë nga banka ,ndërsa me rastin e rivlerësimit kishte kërkuar informacion shtesë dhe siq u sqarua më lart OE i shpallur fitues ka sjellur dëshmi se posedon mjete financiare të gatshme pa pasur nevojë për dokumente për përkrahje nga banka ,pra ky është dallimi që herën e par ishte aprovuar pretendimi ndërsa tani nuk aprovohet i njëjti.

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

OE ankues nderë tjera pretendon se: OE i shpallur fitues nuk e ka vazhduar valeditetin dhe sigurimin e tenderit ,

Ekspertja sqaron se me datë 01.11.2024 është vazhduar paraprakisht sigurimi i tenderit ku në policën e sigurimit shkruan se kjo siguri vlenë për 90 ditë dhe data e fillimit është 01.11.2024 e që i bëjnë se tenderi ka sigurim deri me datën 29.01.2025 ndërsa OE i shpallur fitues vazhdimin e

sigurimit te tenderit e ka bërë me 03.02.2025 e qe nenkupton se me vonesë e ka vazhduar sigurimin e tenderit dhe konstatohet se qendron pretendimi i OE ankues .

E sa i poerket valeditetit te tenderit nuk qendron pretendimi i OE ankues sepse OE I shpallur fitues edhe me rastin e dorezimit te tenderit e ka specifikuar se valediteti I tenderit është per 120 ditë edhe ne vazhdimin e par edhe në vazhdimin e dytë e ka bërë për nga 120 ditë e qe nenkupton se nuk ka ra ne vonesa per valeditetin e tenderit por te njejtin e ka vazhduar ende pa i kaluar afati pra valeditetin e tenderit e ka bër pa vonesa sepse hapja ishte berë me daten 05.08.2024 dhe tani me daten 03.02.2025 e ka vazhduar per heren e dytë qe nenkupton se ne te dyja rastet e ka vazhduar para afatit te skadimit .

Andaj

Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuarë.

OE ankues nderë tjera pretendon se: Grup i Operatorëve Ekonomik KUSHTRIMI NM SH.P.K.; AGRO INVEST 1 SH.P.K.; Xhemshir Sejdiya B.I. është i papërgjegjshëm sepse diplomën dhe kontratën e punës për inxhinierin Skender Cakja e ka ofruar të pa Noterizuar, prandaj është i papërgjegjshëm,I njejta pretendon se ky ofertues nuk e ka vazhduar sigurimin e tenderit dhe pajtohet me eliminimin e tij per shkak te tre antaret e konzorciumit kan perdor deklaratat nenë betim te një aktiviteti tjeter te prokurimit .

Ekspertja sqaron se ky ofertues me te drejt është shpallur i eliminuar sepse mjaftojn deklaratat nenë betim qe nuk janë perdor te ketij aktiviteti te prokurimit dhe te njejtat janë kusht administrativ qe edhe nuk mund te korrigjohen apo te kerkohet ndonje sqarim per te njejtat ,edhe sigurimi i tenderit apo mos vazhdimi i sigurimit te tenderit e eliminon nga gara gjithashtu edhe per kontrata qendron pretendimi i OE ankues.

Ekspertja sqaron se pretendimi është i njejt me pretendimin paraprak,perveq se e ka shtuar edhe si pretendim se OE nuk e ka vazhduar valeditetin e tenderit,andaj edhe një here konstatohet se pretendimi është i bazuar .

Gjithashtu ekspertja sqaron se edhe AK e ka trajtuar si te eliminuar ketë ofertues.

Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njejt pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njejt në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së trajtohet si qështje e gjykuar „res judicata”

Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

OE ankues nderë tjera pretendon se: Grup i Operatorëve Ekonomik Eco Holding Group SH.P.K.; AAB CONSTRUCTION SH.P.K

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (e) është kërkuar personel i certifikuar për gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fjalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Blloqe dhe materiale për muratim, prandaj kjo certifikatë nuk e plotëson kërkesën e cekur më lartë dhe për këtë arsye është dashur të eliminohet nga konkurrenca ky grup i OE.

Kerkesa 1 OE duhet te kete se paku ne tri vitet e fundit qarkullim ne shumen prej 350.000,00 Euro. Kerkesa2 OE duhet te kete te pakten 50.000,00 Euro asete likuide ne llogarin bankare Ose

qasje per kredi nga ndonje banke.

Deshmia 1 Deklarata nga ATK ose raport financiar. Deshmia 2 Deklarata nga banka qe verteton disponueshmerin ne llog. bankare ose vertetim bankar qe kompania mund te marr kredi deri ne shumen e lartecekur.

Grupi i OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi që ka të disponueshme shumën prej 50 mijë euro ose vërtetim bankar që kompania mund të marr kredi në shumën e lartcekur, por i njëjti grup i OE ka ofruar letër përkrahje e cila nuk është aprovim kreditor por është vetëm një letër e Cila i sqaron procedurat e përkrahjes së subjekteve juridike, e që kjo letër i lëshohet secilit OE që e kërkon, e ku sqarohet se nëse kërkon mbështetje financiare do të shqyrtohet financimi, prandaj është dashur të eliminohet nga konkurrenca.

Po ashtu i njëjti grup nuk ka vazhduar sigurimin e tenderi

Ekspertja sqaron se sa i perket pretendimit per stafin se u kerkua personel i certifikuar për gdhendje dhe muratim te gurëve, ndërsa grupi i OE në fjalë për këtë kërkesë ka prezantuar një certifikatë për z Shpetim Sahiti i certifikuar për Muratim me tulla dhe Biloqe dhe materiale për muratim ky pretendim është pjeserisht i bazuar dhe per te njejtin do mundë te kerkohej informacin shtesë bazuar ne nenin 59 dhe 72 te LPP-së ,mirëpo mos dorezimi –vazhdimi i sigurimit te tenderit e eliminon nga gara ketë ofertues ,si dhe mos plotesimi i kriterit per perkrahje financiare nga banka e eliminon ofertuesin me posht e gjeni deklaraten e bankes e cila nuk e ploteson kriterin e paraparë me NJK dhe DT sepse siq u sqarua ma lart është kerkua deklarati se ky Ofertues perkrahet e jo se do te shqyrtohet kerkesa sepse siq ka theksuar OE ankues te gjitha kerkesat shqyrtohen nga banka mirpo disa aprovohen e disa refuzohen shih nje pjes te letres nga banka.

Ky pretendim ka qenë edhe në ankesen paraprake dhe i njejt pretendim është aprovuar me vendimin e OSHP-së nr.2024/1144 dhe i njejt në harmoni me paragrafin 2.16 të nenit 105 të LPP-së rekomandohet te trajtohet si qështje e gjykuar „res judicata”

AndajEkspertja konstaton se ky pretendim është i bazuarë.

OE ankues nderë tjera pretendon se: Grup i Operatorëve Ekonomik Euro Commmerc; ARLINDI SHPK; LEDI SH.P.K. -

Në dosje të tenderit tek neni 9.1&9.2 i FDT-së tek kërkesat tekniko profesionale ne piken (n) është kërkuar certifikatë për menaxhimin e mjedisit ne punishte, kurse grupi i OE në fjalë ka ofruar një certifikatë për z Fatlind Musa e Cila është ISO STANDART 14001 ;2015 edhe për auditor, mirëpo askund nuk shkruan se është për menaxhim të mjedisit në punishte, e që realisht kjo dëshmi nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit , prandaj ky grup i OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.

Ekspertja sqaron se z. Fatlind Musa është i certifikuar me ISO STANDARD 14001:2015 e qe nenkupton se ka qertifikatë te njohur nderkombetarisht, e sa i perket pretendimit se e njejta nuk është adekuate per menaxhimin e mjedisit në punishte ekspertja sqaron se AK mund te kerkojë sqarime nga leshuesit e kesaj qertifikate se e njejta a ka te bej me ketë veprimtari apo ma drejtë të themi me qellimin per te cilin është kerkuar per menaxhimin e mjedisit në punishte,dhe nese e njejta ka ndonjerin nga keto attribute te pranohet nga autoriteti kontraktues .

Ekspertja sqaron se pretendimi është i njëjt me pretendimin paraprak, porveq se e ka shtuar edhe si pretendim se OE nuk e ka vazhduar valeditetin e tenderit, andaj edhe një here konstatoj se pretendimi është pjesërisht i bazuar, mirëpo tani e kemi një dallim nga konstatimi paraprak sepse mosvazhdimi i valeditetit të tenderit është i mjaftueshëm për eliminimin e këtij ofertuesi dhe në rastin konkret edhe po të kërkohej sqarime siq u përmend më lart për qertifikatë prapëseprap rezultati do ishte i njëjt sepse në platformën e e-prokurimit nuk kemi vërejtur se i njëjta ofertues e ka vazhduar valeditetin e tenderit siq ka pretenduar OE ankues. Gjithashtu ekspertja sqaron se edhe AK e ka trajtuar si të eliminuar. Andaj Ekspertja konstaton se ky pretendim është pjesërisht i bazuar.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues;

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritues.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues GOE Dua arch SH.P.K. & Pro&Co Group & NNT ABC & NNT Bini SH.P.K. dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i

kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues e mbështet raportin e ekspertit shqyrtues me rekomandim sipas të cilit ankesa konstatohet si çështje e gjykuar "Res Judicata" dhe lënda kthehet në Rivlersim.

Neni 105 paragrafi 2.16 i LPP-së dhe neni 23.11 i Rregullores së Punes OSHP ka përcaktuar se: "Në rastet e përsëritura me të njëjtat pretendime ankimore, ku objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, në rastet të cilat janë shqyrtuar më parë, Kryetari i Panelit Shqyrtues i trajton si çështje të gjykuara "res judicata". Në bazë të sqarimeve të lartpërmendura, edhe eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të trajtohet si çështje të gjykuar "res judicata" dhe ankesa e OE është e bazuar. Andaj, Paneli shqyrtues mbi ket baze ligjore vendos për të anuluar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues-Komuna Partesh, lidhur me " Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet", me numër të prokurimit; 658-24-7751-5-2-1 dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Paneli Shqyrtues pas analizimit të shkresave të lartpërmendura të cilat i kishte në dispozicion, ankesa e OE ankues, raportin e ekspertit shqyrtues, konstaton se lidhur me çështjen e njëjtë ankimore Organi i Shqyrtimit Publik ka nxjerr Vendimin PSh. nr.2024/1144. Vendimet e OSHP-së janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese dhe të gjitha palët në procedurë, dhe se kundër vendimeve të OSHP-së, palët mund të ankohen në gjykatën kompetente brenda afatit ligjor me mjete të rregullta juridike, në përputhje me këshillën juridike të dhënë në vendim. Andaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues (AK) / Komuna Parteshit, që lidhur me aktivitetin e prokurimit " Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet", me numër të prokurimit; 658-24-7751-5-2-1 të zbatohen vendimet e OSHP-së.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit " Ri-Tender: Rregullimi i shtratit te lumit ne fsh.budrig e ulet", me numër të prokurimit; 658-24-7751-5-2-1. Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vlerëson se AK Komuna e Parteshit vlerësimin e ofertave nuk e ka bërë konform nenit 59 të LPP gjetje te cilat kane ne raportin e pare të ekspertit shqyrtues dhe tani po ashtu të raportit të dyte të ekspertit shqyrtues me konstatim dhe rekomandim që lënda duhet kthyer në ri-vlerësim dhe të shqyrtohet prapë nga ana e AK.

Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të anulohet dhe kthehet sërish në Ri-vlerësim, sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të

këtij ligji”.

Paneli konstaton se zyrtari përgjegjës i prokurimit dhe komisioni i ri-vlerësimit gjatë vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk kanë marrë për bazë konstatimet e Vendimit nr.2024/1144 të OSHP-së. Mos zbatimi i vendimeve të OSHP-së konsiderohet si shkelje e rëndë me Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 002/2024 nenin 97 pika h: “Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së”.

Paneli shqyrtues po ashtu duke u bazuar nga të gjitha faktet, arsyet dhe gjendjen faktike që u përshkrua si më sipër, konstaton se Autoriteti kontraktues, nuk i ka vlersuar tiparet kryesore të LPP-së, që janë ekonomiciteti, efikasiteti dhe kursimi i buxhetit të shtetit, për këto aktivitete të prokurimit, ka parashikuar vlerën e kontratës, në shumë prej: 211,275.30 Euro dhe ka rekomanduar për kontratë ofertën e cila është ekonomikisht më e pafavorshme, përkatësisht me të shtrejte në shumën prej 207,005.78 Euro, ndërsa operatori ekonomik ankues ka ofertuar me më qmim me të lirë në shumën prej 192,189.72 Euro, që i kontribuon parimit të kursimit të buxhetit të shtetit.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA PARTESH**
- **OE - Dua arch SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: